



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:277291
Datë: 15.01.2024
Numri i dokumentit: 05191718

C.nr.7136/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.Z., U.Gj.M. dhe H.M., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokat L.B. nga P..., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i ushqim (shujtave), jashtë seancës, me datë 15.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.Z., U.Gj.M. dhe H.M. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësve t'i paguaj shumat si në vijim :

Paditëses së parë: A.Z., në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 552 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,104.00 €.

Paditëses së dytë: U.Gj.M., në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 549 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,098.00 €.

Paditëses së tretë: H.M., në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 552 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,104.00 €.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve t'ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 23.12.2022 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 248.00€, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 23.12.2022, kane parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim për ushqim. Në padi dhe në precizimin e datës 17.10.2023 ka paraqitur se paditëset janë të punësuar tek e paditura në SHFMU në Prishtinë, si mësimdhënëse të mësimit klasor, me kontratë pune në kohë të pacaktuar e lidhur ndërmjet paditësve dhe të paditurës. Ka theksuar se paditësve nuk i 'u është bërë kompensimi për ushqim ditor në vlerë prej 2€ dhe atë: për paditësen e parë A.Z., për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 552 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,104.00 € , për paditësen e dytë U.Gj.M., për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 549 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,098.00 €, për paditësen e tretë H.M., për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri në 31.08.2022, gjithsej për 552 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,104.00 €. Tutje ka theksuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, paditësve ju takon e drejta për kompensim për ushqim gjatë punës në bazë të nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate të nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka

paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratave të punës dhe atë: paditësja e parë A.Z., sipas kontratës së punës të datës 10.03.2015, paditësja e dytë, U.Gj.M., sipas kontratës së punës të datës 03.03.2015, paditësja e tretë, H.M., sipas kontratës së punës të datës 03.03.2015.

Gjykata përmes vërtetimeve mbi përvojën e punës dhe ditët e prezencës në punë për paditëset gjeti si vijon: paditësja A.Z. sipas vërtetimit të datës 09.11.2022 ka 552 ditë prezentë në punë, paditësja U.Gj.M. sipas vërtetimit të datës 09.11.2022 ka 549 ditë prezentë në punë, paditësja H.M. sipas vërtetimit të datës 09.11.2022 ka 552 ditë prezentë në punë.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset nuk kane pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërehet se paditësja A.Z. ka 552 ditë prezence në punë, paditësja U.Gj.M. ka 549 ditë prezence në punë, paditësja H.M. ka 552 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar 2€, rrjedhimisht duke u 'a njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditësve në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së: "Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë.

Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtorëve të arsimit në kompensimin e ushqimit, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i ‘u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për ushqim gjatë punës, e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditëset e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e shpenzimeve të ushqimit i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditëset në rrugë gjyqësore kane filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e

buxhetit të të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 23.12.2022.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 248.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 208.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 40.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.7136/22, datë 15.01.2024

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.